

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prapaskena e incidentit me Zelensky-n: droni rus, alarmi dhe avioni që nuk u nis
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/prapaskena-e-incidentit-me-zelensky-n-droni-rus-alarmi-dhe-avioni-qe-nuk-u--i585127
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 09:31:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 10:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	24501b1d281cdc8840e38fffd72e58cd01342dd75110fbbc456003f487484f5
TEKSTI	4731bc4152cf27d9210dd3aae58996a9e5a3f10f6a1da7e38c484374343c49dc
PAMJA	ec9262e1300e4513e065f26616479fbdbb6865800defb1b5e6c7e0dbb5f13942

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67a460f204c6926439d9a5960d0d67927d3619ef59a60250ca595ff702dfcddd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67a460f204c6926439d9a5960d0d67927d3619ef59a60250ca595ff702dfcddd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e Ngërci për pagat përshin edhe Beratin, Gjiykata në bojkot: Trajtohen vetem masat e sigurisë dhe urdhrat e mbrojtjesAvionet polake dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrai
fundit

Prapaskena e incidentit me Zelensky-n: droni rus, alarmi dhe avioni që nuk u nis

10 Shtator 2026, 12:15Bota TEMA



 Prapaskena e incidentit me Zelensky-n: droni rus, alarmi dhe avioni që nuk

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ishte duke u nisur nga Moldavia drejt Norvegjisë, kur avioni me të cilin udhëtonte u përball me një kërcënim nga një dron.

Lajmin e bëri të ditur kryeministri norvegjez Jonas Gahr Store në një intervistë për televizionin norvegjez NRK. Ai tha se Zelensky ia kishte treguar ngjarjen gjatë një bisede që patën pak para se të merrnin pjesë në ceremoninë mortore të mbretit Harald.

“Ky është realiteti me të cilin duhet të përballët presidenti ukrainas”, tha Store.

Edhe ministri norvegjez i Financave, Jens Stoltenberg, ishte i pranishëm gjatë bisedës. Ai konfirmoi se fluturimi i Zelensky-t ishte vonuar dhe se kishte pasur kërcënime ndaj avionit.

Megjithatë, Stoltenberg tha se nuk kishte mjaftueshëm informacion për të dhënë më shumë detaje.

Ai vlerësoi gjithashtu faktin që Zelensky kishte marrë pjesë në ceremoninë mortore dhe kishte qëndruar pranë liderëve të tjerë evropianë. Sipas Stoltenbergut, në udhëtimet e mëparshme të Zelenskyt jashtë Ukrainës, masat e sigurisë kanë qenë shumë të rrepta dhe daljet e tij publike kanë qenë të kufizuara.

Çfarë ndodhi me dronin?

Nga Kiev, ngjarja u paraqit si më pak alarmante.

Një burim pranë presidencës ukrainase i tha AFP-së se bëhej fjalë për një alarm në Moldavi, pasi një dron rus kishte hyrë në hapësirën ajrore moldave dhe më pas kishte kaluar në atë të Rumanisë.

Sipas këtij burimi, ishte e ekzagjeruar të thuhej se Zelensky kishte qenë në rrezik të drejtpërdrejtë.

Ministria e Mbrojtjes së Moldavisë konfirmoi se një dron i tipit Shahed kishte hyrë në hapësirën ajrore të vendit dhe më pas kishte kaluar në territorin ajror të Rumanisë.

Për shkak të incidentit, hapësira ajrore u mbyll për kohësisht dhe avionët luftarakë të NATO-s u ngritën në ajër.

Nuk është ende e qartë nëse droni kishte synuar avionin e Zelensky-t. Një nga mundësitë është që nisja e avionit të presidentit ukrainas të jetë shtyrë për arsye sigurie, për shkak të situatës që po zhvillohej në ajër.

Tensionet në rajon

Incidenti ndodhi në një kohë kur tensionet në hapësirën ajrore të vendeve pranë Ukrainës janë rritur ndjeshëm.

Vetëm një ditë më parë, Moldavia dënoi sulmet ruse ndaj Ukrainës pranë pikës kufitare Tudora-Starokozache. Sulmet shkaktuan dy viktima dhe disa të plagosur, mes tyre edhe pjesëtarë të rojes kufitare ukrainase.

Ngjarja me avionin e Zelensky-t tregon edhe një herë se lufta në Ukrainë po krijon rreziqe edhe për vendet dhe hapësirat ajrore përreth saj.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Avionët polakë dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrainë](#)

11:15 Bota

[Irani dërgohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së: Vendimi i parë i këtij lloji në 20 vjet](#)

11:05 Bota

[Alarmi për klimën - Gushti 2026 regjistrohet si muaji më i nxehtë në histori, “El Niño” pritet të rrisë më tej tempe](#)

10:15 Bota

[Teherani kundërpërgjigjet ndaj SHBA-së, sulme ndaj anijeve luftarake dhe cisternave në Hormuz](#)

09:55 Bota

[‘Fjalim 1 orë e 45 minuta’, Trump premton 5 mijë dollarë për çdo të rritur amerikan nëse fitojnë zgjedhjet e mesmandatit në nëntor](#)

09:35 Bota / 6 komente

[Trump: Lufta me Iranin do të përfundojë menjëherë pas zgjedhjeve të mesit të mandatit në SHBA](#)

22:40 Bota / 11 komente

[Aksident i rëndë në Poloni, treni përplaslet me betonieren, 1 i vdekur dhe 20 të plagosur](#)

22:30 Bota

[Dron pranë avionit të Zelenskyt, kryeministri norvegjez: Pothuajse u godit](#)

22:20 Bota / 4 komente

[Spanja përjetoi verën më të nxehtë në historinë e matjeve të temperaturës](#)

21:20 Bota

[Shpërthimi në hidrocentralin në Zvicër/ Objekti përfshihet nga flakët, humbin jetën dy persona](#)

20:40 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Republika popullore e protestës](#)

15:20 Editorial / 106 komente

[“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...](#)

11:53 Politika / 100 komente

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...](#)

14:50 Kronika / 19 komente

[U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...](#)

15:13 Politika / 71 komente

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...](#)

13:40 Bota / 38 komente

Blog Tema

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog

[Dinjtet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 12 komente

[Programi i ri politik i Partisë Demokratike](#)

08:45 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)

- [Shërbeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.